FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

PROPRANOLOL

Tableta - 40 mg
(Propranolol klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Propranolol dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Propranolol
3. Si ta merrni Propranolol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Propranolol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PROPRANOLOL DHE PËRSE PËRDORET

Propranolol përmban përbërësin aktiv propranolol klorhidrat, i cili bën pjesë në grupin e beta - bllokuesve.
Tabletat Propranolol - 40 mg përdoren:
- në kontrollin e hipertensionit;
- në trajtimin e angina pektoris;
- në parandalimin e atakeve të tjerë kardiakë, në rast se ju e keni kaluar një të tillë;
- në trajtimin e kardiomiopatisë hipertrofike;
- në kontrollin e aritmive.

Gjithashtu, tabletat Propranolol mund të përdoren edhe:
- në parandalimin e dhimbjes së fortë të kokës (migrenës);
- në trajtimin e tremorit esencial;
- në kontrollin e ankthit dhe takikardisë të shkaktuar nga ankthi;
- si trajtim ndihmës në hiperaktivitetin e gjendrës tiroide (tirotoksikozë);
- në trajtimin e hipertensionit të shkaktuar nga tumori në gjendrën adrenale - feokromocitomë (vetëm me një alfa - bllokues);
- në parandalimin e hemorragjisë së pjesës së sipërme të traktit gastrointestinal në pacientët me tension të lartë në mëlçi dhe variçe të ezofagut.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PROPRANOLOL

Mos merrni Propranolol në qoftë se:
- jeni alergjik (keni mbindjeshmëri) ndaj propranolol klorhidratit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari;
- keni vuajtur nga astma bronkiale, bronkospazma ose bronkopneumopatia kronike obstruktive (BPCO);
- keni probleme kardiovaskulare si: insufiçiencë kardiake e pakontrolluar, rrahje të ngadalta ose jo të rregullta të zemrës, shok kardiogjen, çrregullime të rënda të qarkullimit arterial periferik, bllokim atrioventrikular të gradës së dytë dhe të tretë, sindromë të sinusit të sëmurë, anginë Prinzmetal (dhimbje në gjoks ndërsa pushoni e jo ndërsa ushtroheni);
- keni tension të ulët të gjakut;
- nuk jeni ushqyer për një kohë të gjatë ose nëse gjaku juaj është bërë shumë acid (acidozë metabolike);
- keni hipertension të shkaktuar nga feokromocitoma, që është një tumor i gjendrave adrenale (përveç rastit kur e keni trajtuar me alfa - bllokues);
- jeni duke marrë verapamil ose diltiazem.

Tregoni kujdes të veçantë gjatë përdorimit të këtij bari
Përpara se të merrni tabletat Propranolol tregojini mjekut tuaj nëse:
- keni kaluar një reaksion anafilaktik, sepse ndjeshmëria ndaj alergjenëve mund të rritet;
- keni *Myasthenia gravis;*
- keni bllokim atrioventrikular të gradës së parë;
- keni sëmundje të zemrës të shkaktuara nga pakësimi i furnizimit të këtij organi me gjak (sëmundje të zemrës iskemike);
- keni sindromin Raynaud (sëmundje që shkakton ndjenjë të ftohti në gishtërinj) apo çalim të herëpashershëm (sëmundje e shkaktuar nga ngushtimi i arterieve në këmbë, gjë që shkakton dhimbje gjatë ecjes e si pasojë çalim);
- keni çrregullim të funksionit të veshkave ose mëlçisë (hipertension portal);
- keni diabet të sheqerit;
- keni hipoglicemi apo tirotoksikozë, sepse simptomat e tyre mund të maskohen;
- keni një sëmundje të lëkurës e quajtur psoriazë, ose nëse keni vuajtur më parë nga një sëmundje e tillë;
- do të bëni një test për të verifikuar praninë e glaukomës, sepse Propranolol mund të ulë presionin intraokular;
- jeni në periudhën e shtatzënisë ose të ushqimit me gji të foshnjes.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Propranolol. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Propranolol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke marrë ose duke u trajtuar me:
- diltiazem, nifedipinë, verapamil ose digoksinë, që përdoren për trajtimin e sëmundjeve të tjera të zemrës;
- klonidinë, bar që përdoret për mjekimin e hipertensionit dhe migrenës;
- rezerpinë;
- cimetidinë ose hidroksid alumini, barna që përdoren në rastin e hiperaciditetit në stomak;
- hidralazinë, bar për mjekimin e hipertensionit;
- kinidinë, disopiramid ose amiodaron që përdoren në trajtimin e rrahjeve të çrregullta të zemrës;
- insulinë, apo barna që përdoren në trajtimin e diabetit;
- teofilinë, që përdoret për trajtimin e astmës;
- rifampicinë, që përdoret për trajtimin e tuberkulozit;
- varfarinë, që përdoret si antikoagulant oral;
- rizatriptan dhe derivatet e ergotaminës, që përdoren në trajtimin e migrenës;
- adrenalinë, që përdoret në trajtimin e anafilaksisë;
- tiroksinë;
- haloperidol;
- antidepresivë triciklikë, barbiturate, fenotiazinikë, anestezikë ose frenues të sintezës së prostaglandinave.

Marrja e tabletave Propranolol me ushqim dhe pije
Nuk duhet të konsumohet alkool gjatë mjekimit me Propranolol, sepse alkooli mund të ndryshojë mënyrën si vepron propranololi në organizëm.

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.
Nëse jeni shtatzënë, planifikoni një shtatzëni apo ushqeni fëmijën me gji, duhet të këshilloheni me mjekun tuaj përpara se të filloni mjekimin me Propranolol.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Ky bar nuk ka prirjen të ndikojë në aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri. Megjithatë, ndonjëherë gjatë mjekimit me Propranolol, mund të ndjeni marrje mendsh ose lodhje. Nëse kjo ndodh, mos përdorni automjetin apo makineri të tjera dhe tregojini menjëherë mjekut tuaj.

Informacion i rëndësishëm mbi disa nga përbërësit e Propranolol
Ky bar përmban laktozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, kontaktoni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI PROPRANOLOL

Gjithmonë merreni Propranolol vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Propranolol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Këshillojmë që tabletat t'i merrni në të njëjtën orë çdo ditë.
Tabletat e Propranolol duhet të gëlltiten të plota me një gotë ujë.
Ky preparat është vetëm për përdorim oral.

Dozimi i Propranolol është si më poshtë:
Të rriturit
Hipertension: doza fillestare 80 mg në ditë. Doza mbajtëse është 160 – 320 mg në ditë.
Anginë: fillimisht 40 mg, 2 - 3 herë në ditë; doza mbajtëse është 120 - 240 mg në ditë.
Profilaksi pas infarktit të miokardit: 40 mg, 4 herë në ditë për 2 - 3 ditë, më pas 80 mg dy herë në ditë, duke filluar nga dita e 5-të deri në ditën e 21-të pas infarktit.
Aritmi, Kardiomiopati hipertrofike, Takikardi anksioze dhe Tirotoksikozë: 10 - 40 mg, 3 - 4 herë në ditë.
Profilaksi e migrenës dhe Tremor esencial: fillimisht 40 mg 2 - 3 herë në ditë; doza mbajtëse është 80 - 160 mg në ditë.
Ankth me simptoma të tilla si palpitacion, djersitje, të dridhura: 40 mg një herë në ditë. Nëse është e nevojshme, doza mund të rritet në 40 mg, 3 herë në ditë.
Feokromocitomë (të përdoret vetëm me një alfa – bllokues): 60 mg në ditë për 3 ditë përpara ndërhyrjes kirurgjikale ose 30 mg në ditë, në pacientët që nuk mund t'i nënshtrohen ndërhyrjes kirurgjikale.
Parandalim i hemorragjisë së pjesës së sipërme të traktit gastrointestinal: fillimisht 40 mg, 2 herë në ditë; doza mund të rritet deri në 160 mg, 2 herë në ditë kur është e nevojshme.

Fëmijët
Fëmijët nuk mund të trajtohen me Propranolol veçse nën vëzhgimin strikt të mjekut.
Për mjekimin e çrregullimeve të ritmit kardiak, feokromocitomës ose tirotoksikozës, doza e rekomanduar për fëmijët është 0.25 - 0.5 mg/kg, 3 deri në 4 herë në ditë.
Për profilaksinë e migrenës, doza është nga 20 mg 3 - 4 herë në ditë. Ky dozim vlen për fëmijët më pak se 12 vjeç. Fëmijëve mbi 12 vjeç u jepet e njëjta dozë me të rriturit.

Në qoftë se keni marrë më shumë Propranolol
Në qoftë se keni marrë më shumë Propranolol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmija juaj e ka marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshilla për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Propranolol
Në qoftë se harroni të merrni një dozë Propranolol (ose më shumë doza), merrni dozën pasardhëse kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të madhe) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Propranolol
Propranolol nuk duhet të ndërpritet menjëherë pas një përdorimi të zgjatur, por në mënyrë graduale. Ndërprerja e menjëhershme mund të rezultojë në anginë, infarkt miokardi, aritmi ventrikulare, dhe vdekje.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, edhe tabletat Propranolol mund të shkaktojnë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Nëse ju shfaqet një nga efektet anësore të mëposhtme, ndërpriteni mjekimin me Propranolol dhe kontaktoni menjëherë mjekun tuaj:
- ngadalësim i rrahjeve të zemrës, insufiçiencë kardiake që përkeqësohet (shenjat përfshijnë vështirësi në frymëmarrje ose enjtje të kyçeve);
- marrje mendsh dhe gjendje të fikti;
- qarkullim i dobët i gjakut periferik, që çon në zhvillimin e ngërçeve në këmbë (sindroma Raynaud);
- ulje e nivelit të sheqerit në gjak (hipoglicemi) tek pacientët që nuk vuanin më parë nga diabeti (shenjat përfshijnë: dobësi, dhimbje koke, ndenjë urie, çrregullime të të parit dhe ndryshime të humorit);
- shfaqje e njollave ngjyrë vjollcë në lëkurë;
- dobësim i muskujve si dhe përkeqësim i sëmundjes së muskujve të quajtur *Myasthenia gravis.*

Nëse ju shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mëposhtme, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj:
- skuqje dhe puçrra të vogla në lëkurë (rash), filluska në lëkurë, teshtima, shtrëngim në kraharor apo kolaps. Këto shenja tregojnë për një reaksion alergjik ndaj tabletave Propranolol;
- bronkospazëm;
- dhimbje koke;
- ndjenjë konfuzioni;
- ndryshime të humorit;
- zhurma të çuditshme dhe haluçinacione;
- makthe, lodhje dhe pagjumësi;
- ndjenjë të ftohti dhe pickimi në gishtërinj;
- ndryshime në përqëndrimet plazmatike të trigliceridëve dhe kolesterolit;
- ndjenjë e të qenit i sëmurë, dhimbje barku, diarre, të përziera, të vjella;
- prurit, përkeqësim i psoriazës;
- alopeci;
- impotencë;
- tharje e syve, ndryshime të të parit.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PROPRANOLOL

Ruajeni barin larg fëmijëve!
Mos i përdorni tabletat Propranolol pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë tabletat Propranolol
Lënda vepruese është Propranolol klorhidrat.
Çdo tabletë përmban 40 mg propranolol klorhidrat.
Përbërës të tjerë janë: laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, talk, stearat magnezi.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 60 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja. Kujdes. Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 x 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.